


# GUTENBERG NKOUNKE







| | |
|---|---|
| **DATE OF BIRTH:** | 16 Sept 1985 |
| **NATIONALITY:** | French |
| **PROFESSION:** | Footballer |
| **POSITION:** | Goalkeeper |
| **HEIGHT:** | 187 cm |
| **WEIGHT:** | 85 kg |

**TECHNICAL INFORMATION:**

He is a goal keeper with a big frame.
He's got excellent reflexes in goal and a very good reaction.
He is always well-positioned and focused behind his defence.
He steers, guides the defence well, and possesses a feline spirit in goal.

**FORMER CLUBS:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| OGC Nice Academy | (France) | 1997-2003 | |
| KF Partizani Tirana | (Albania) | 2003-2005 | Played UEFA Cup Games. |
| AS Saint-Étienne | (France) | 2005 pre-season | |
| Saarbrucken Brebach | (Germany) | 2005-2006 | |
| Jeunesse Star Yaounde | (Cameroon) | 2006-2007 | |
| Hong Kong Rangers | (China) | 2007-2009 | |
| RCD Mallorca | (Spain) | 2010 pre-season | |

## PARTIZANI - VLLAZNIA
**(sot, ora 15.00, në stadiumin "Qemal Stafa")**

**Partizani**

Të skualifikuar: s'ka

Kartona të verdhë: Allmuça, Ndreka, Bylykbashi, Bakaj

Të dëmtuar: Lika

Formacioni i mundshëm (3-5-2): Gutenberg, Ndreka, Grizha, Alcani, Hallaçi, Allmuça, Do Santos, Bylykbashi, Rodrigues, Karioka, Bakaj (Ristani, Doka, Lionel, Metani, Arifaj, Plaku)

**Vllaznia**

Të skualifikuar: s'ka

Të dëmtuar: Ziambo

Kartona të verdhë: Liçaj, Teli, Olivera, Kraja(2), Belisha(2)

Formacioni i mundshëm (4-4-2): Shehi, Teli, Doçi, Kraja, Olivera, Belisha, Lici, Hoti, Leandro, Salihi, Abilio (Ndoja, Ahi, Selmani, Brajoviç, Egerçi, Beqiri, Bishja, Beka, Ziambo)

# Partizani fiton, por njolloset gjyqtari

Nga Tirana, JETON SELIMI

FK PARTIZANI **3** — **1** KS VLLAZNIA

*Shënues:* Ndreka 59', Bylykbashi 65' (11-m), Karioka 90'\ Salihi 27'

## PARTIZANI - VLLAZNIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Gutenberg | 7 | 1. Shehi | 6 |
| 2. Ndreka | 7 | 2. Lici | 5 |
| 3. Alcani (Hasmeta 38') | 6.5 | 3. Teli | 5.5 |
| 4. Grizha | 6.5 | 4. Kraja | 5.5 |
| 5. Bakaj | 6 | 5. Belisha (Ahi 60') | 5 |
| 6. Hallaçi | 6.5 | 6. Abilio | 6 |
| 7. Allmuça | 6.5 | 7. Hoti (Egerçi 74') | 5.5 |
| 8. Doku (Arifaj 17') | 6 | 8. Salihi | 6.5 |
| 9. Bylykbashi | 7 | 9. Doçi | 5.5 |
| 10. Karioka | 6.5 | 10. Oliviera | 5.5 |
| 11. Veloso (Abilaliaj 81') | 6.5 | 11. Leandro | 5.5 |

*Trajner:* Ilir Shulku — *Trajner:* Vasil Bici

*Gjyqtarë:* S.Çekaj (Laç), F.Elezi (Durrës), D.Rexha (Tiranë)
*Kartonë të verdhë:* Gutenberg, Grizha, Hallaçi, Bylykbashi\ Teli, Belisha, Abilio, Doçi
*Karton i kuq:* Lici



Nga ndeshja e djeshme e "Qemal Stafës", Partizani-Vllaznia 3-1 — Foto: ALNA

Histori statistikore
**Partizani-Vllaznia**

# PARTIZANI - TURBINA 1-1

Partizani: Gutenberg, Grizha, Hallaçi, Hasmeta, Rodrigues, Da Silva, Bakaj (Metani 55', Gjeloshi 73'), Sula, Allmuça, Veloso, Karioka. Trajner: I.Shulku
TURBINA: Hoxha, Samarxhiu, Metaj (Koçiaj 40'), Leka, Brari, Shalari, Sekseri, Zdrava (Maloku 80'), Baja, Osmanlliu (Ranxha 77'), Jani. Trajner: L.Metani
Golat: Allmuça 57'(11-m), Sekseri 62'
Gjyqtarë: S.Velçani, A.Mali, H.Velçani (Patos)
Kartonë të verdha: Karioka, Da Silva, Leka, Jani

Partizani kalon për në turin e ardhshëm të Kupës së Shqipërisë. Takimi i zhvilluar dje në qytetin e Fushë-Krujës midis të kuqve dhe miqve nga Cërriku ka përfunduar në barazim 1-1. Partizani e ka pasur të vështirë ta mposhtë për të dytën herë Turbinë dhe, falë fitores së arritur një javë më parë në fushën e Cërrikut, u kualifikua. Pjesa e parë është dominuar nga futbollistët e Cërrikut, ku vlejnë të përmenden disa raste të pastra për shënim, por ka qenë portieri Gutenberg ai që nuk ka lejuar prekjen e rrjetës. Pra, në këtë pjesë, futbollistët e Partizanit kanë qenë shumë pasivë, ndërkohë që krejt ndryshe është paraqitur tabloja në pjesën e dytë për të dy ekipet. Partizani ka korrigjuar disa të meta në mesfushë dhe arrin të sulmojë rrezikshëm me anë të dy sulmuesve, Karioka dhe Veloso. Ky i fundit fiton edhe një 11-metërsh, të cilin e kthen në gol Allmuça. Vetëm 5 minuta pas shënimit të golit nga Partizani, cërrikasit i janë përgjigjur me anë të Sekserit, që barazon rezultatin. Turbina e ka rrezikuar sërish portën kundërshtare, por vetëm shtyllat nuk e kanë lejuar topin të përfundojë në rrjetë dhe gjithçka mbyllet në barazim.

## Deklarojnë:

**Ilir Shulku, trajner i Partizanit:** *"Rëndësi ka kualifikimi, pasi me ndeshjen që zhvilluam sot treguam se Partizani ka probleme të shumta që duhen zgjidhur mjaft shpejt. Ndeshja me Tiranën është në prag dhe ne duhet të përgatitemi si duhet."*

**Luan Metani, trajner i Turbinës:** *"Synimi ynë ishte përfaqësimi dinjitoz dhe ashtu ndodhi. Nuk kishim ndonjë pretendim serioz për kalimin e turit, por duke parë një Partizan të plogësht, dëshira për kualifikim mund të ishte realizuar."*

Rajmond GJOKA

Gutenberg

Pas kualifikimit për në turin e tretë të Kupës së Shqipërisë, të kuqtë përqendrohen te derbi

# Derbi troket, Partizani në "rresht"



Kur kanë mbetur vetëm dy ditë nga zhvillimi i takimit të shumëpritur Partizani-Tirana, të kuqtë nuk duan që t'u shkojë kot asnjë minutë. Trajneri Shulku kërkon tendosje maksimale nga të tijtë, ndërsa po përpiqet që të gjejë formacionin më të mirë të mundshëm mes lojtarëve që ka. E ndërsa alternativat nuk janë të shumta, stafi teknik i Partizanit po tenton që të rikuperojë sa më shpejt lojtarët e dëmtuar. Alcani dhe Lika vijojnë të bëjnë stërvitje individuale dhe shpresojnë që të jenë të gatshëm për trajnerin Shulku në sfidën e fundjavës. Gjithashtu, shpresohet shumë në rikuperimin e formës fizike të katër prej brazilianëve, të cilët i kanë të gjitha letrat në rregull. Në takimin e fundit, të vlefshëm për kampionat, ku të kuqtë u përballën me Vllazninë, sulmi i Partizanit përbëhej nga dyshja Karioka-Veloso, ndërsa Rodrigo e Da Silva kanë qëndruar në stol. Gjithashtu, drejtuesit e Partizanit janë në pritje të lejekalimeve të pesë brazilianëve të tjerë, të cilët gëzojnë formë të mirë fizike dhe nuk do ta kishin aspak problem përfshirjen në skuadër në takimin me bardheblutë. Por, ndryshe nga dëshira e krerëve të kuq, ata nuk do të mund të aktivizohen nëse më parë nuk pajisen me lejekalimet përkatëse.

Por pjesa tjetër e skuadrës është në formë të mirë. Sfida ndaj shkodranëve nxori më pas një karakter të fortë dhe një dëshirë të madhe për të fituar. Këtë ka kërkuar sërish trajneri Shulku, i cili e di mirë se një faktor i tillë do të jetë shumë determinues në një takim tepër të rëndësishëm. Tirana, e cila deri më sot nuk ka pasur asnjëherë "dhimbje koke", vjen e kompletuar dhe ka nga dy lojtarë cilësorë në çdo repart. Krejt ndryshe tabloja e kuqe, ku Shulkut i është dashur që edhe dje, në takimin me Turbinën, takim ky i vlefshëm për kupë, të kursejë sa më shumë elementë, pasi u druhej dëmtimeve të ndryshme. Derbi mbetet një derbi dhe këtë e dinë mirë më shumë se kushdo tifozët, të cilët kërkojnë me çdo kusht fitoren e skuadrës së zemrës.

Jeton SELIMI